

Nr. regj. 14841/12

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK/DMP
Nr. i taq. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	03-1010/12
Data Datum Date	06.11.2012
PRISTINE	

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, Gjyqtarja Lindita Jakupi me pjesëmarrjen e sekretares juridike Ardita Azemi, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër Flora Brovina nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 5,6 paragrafi 1.2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtareve të Lartë Publik nr. 04/L-050, e në bazë të nenit 73.73.195, 199 si dhe neni 10 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me dt. 31.10. 2012, merre këtë:

AKTVENDIM

I PANDEHURI: Flora Xhavit Brovina, i lindur më 29.06.1949 në Skenderaj, ku edhe tani jeton në Prishtinë, i martuar, Deputete në Parlamentin e Kosovës, me shkollim superior, e gjendjes së mesme ekonomike, deri tani thotë jo i dënuar.

Ë shtë përgjegjës

Sepse me si Zyrtar i lartë Publik, në Deputete në Parlamentin e Kosovës, nuk e ka bërë deklarin e rregullt të gjendjes së pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, brenda afatit ligjor me 31.03.2012,

- me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 5,6 paragrafi 1.2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 2 të ndëshkuar me nenin 17 parag. 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtareve të Lartë Publike, andaj të pandehurit për këtë kundërvajtje i shqiptohet,

Q O R T I M

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës. Shpenzime të procedurës nuk ka patur.

A r s y e t i m

Agjencinë Kundër Korrupsionit në Prishtinë, parashtroi kërkesën nr. 01 1624/2012 të dt. 30.04.2012, për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të shënuar për kundërvajtjen e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në bazë të kërkesës së ushtruar, Gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurës e cili në mbrojtjen e vet deklaroi se si Deputete e Parlamentin të Kosovës, çdo here ka përmbushur obligimin për deklarin e pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe gjithmonë kam qenë e gatshme të bashkëpunoj me AKK, si dhe për çdo ndryshim të vogël në pasurinë saj kam njoftuar Agjencinë Kundër Korrupsionit. Me tej shton se kësaj radhe është vonuar pak ta deklaroj pasurinë brenda afatit ligjor të paraparë sipas Agjencinë Kundër Korrupsionit pasi në muajin Mars të vitit 2012, ka pasur shumë angazhime jashtë vendit si në Shqipëri dhe në Austri, dhe si prova materiale ka prezantuar pasaportën në origjinal ndërsa kopjen ia ka bashkangjitur shkresave të lendes, Gjithashtu ka deklaruar se Biletat e udhëtimit i ka dorëzuar në Agjencinë kundër Korrupsionit në kohën kur ka dorëzuar formularin për deklarin të pasurisë.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjyqtari morri në pyetje dëshmitarën –Valbona Zeqiri, Zyrtare në Agjencinë kundër Korrupsionit në Prishtinë, cila ka deklaruar: se mbetet në tërësi pranë kërkesës për kundërvajtje ndaj të pandehurës, e cila nuk e ka respektuar afatin ligjor për aplikim të pasurisë, i cili ishte përcaktuar deri më 31 Mars 2012. Me tej në deklaratën e saj shton se e pandehura çdo here ka përmbushur obligimin për deklarin e pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit përveç kësaj radhe që është vonuar pak.

Me vlerësimin i deklaratës së të pandehurës, ushtruesit të kërkesës, Zyrtar në Agjencinë Kundër Korrupsionit, dhe bazë të dhënave të parashtruara në kërkesë, shqimit të shkresave të lendes dhe provave të tjera të administruara gjatë procedurës, gjyqtarja në masë të mjaftuar vërtetoi se e pandehura, ka bërë kundërvajtje ashtu si e rëndon kjo kërkesë, andaj për këtë është shpallur fajtor dhe për çka të pandehurën e ka shpall përgjegjës dhe konform neni 10 të LMK, i shqiptoi dënim qortimi pasi e pandehuri ka çdo here ka për mbushur

03-4010/12/02
Sung

obligimin për deklarimin e pasurisë në AKK dhe vonesën për deklarim të pasurisë e ka bërë pasi ka qenë shumë e angazhuar në punë.

Me rastin e shqiptimit të denimit Gjyqtarja vlerësoi të gjitha rrethanat konform nenit 7 të LMK andaj të LMK-ës të pandehurës i shqiptoi qortimi mori si rrethanë lehtësuese pasi e pandehura çdo herë ka respektuar afatin ligjor për deklarimin e pasurisë, pastaj udhëtimet jashtë vendit të cilat i ka pasur gjatë muajit Mars të vitit 2012, ka deklaruar pasurinë pas aftit ligjor po nuk ka shkaktuar kurrfarë pasja, Andaj bazuar në të cekurat si më lartë Gjyqtarja i shqiptoi masën e Qortimit duke llogaritur se edhe me këtë llojë të denimit të i pandehuri mund të arrihet efekti i sanksionimit që i pandehuri në të ardhmën mos të kryej kundërvajtje të këtilla dhe të ngjajshme.

Me sa u cekë më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

UVENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

GJYQTARJA

Lindita Jakupi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë, brenda 8 ditësh pas marrjes së të njëjtit dhe pa taksë.